



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L– 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), të dispozitave të nenit 5, paragrafi 5.2 dhe nenit 8, paragrafi 8.2 të Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike, të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.01.2018, merr këtë

**VENDIM
PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE NË KOMISIONET E AKSIONARËVE TË
NDËRMARRJEVE PUBLIKE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS**

CAKTOHEN anëtarët e komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës: Ngrohtorja e qytetit “Termokos”, SHA; Ndërmarrja Publike Banesore, SHA; Kompania rajonale e mbeturinave “Pastrimi”, SHA; Ndërmarrja publike “Hortikultura”, SHA; Ndërmarrja publike “Trafiku Urban”, SH.A.; Ndërmarrja publike “Sport - Marketing”, SHA; Stacionit i Autobusëve në Prishtinë, SHA, dhe “Prishtina Parking” SHA.

I.

Anëtarë të komisioneve të cekura në pikën I të këtij vendimi janë:

1. Ngrohtorja e qytetit “Termokos”, SHA:

1. Nol Nushi,
2. Arbenita Murseli.

2. Ndërmarrja Publike Banesore, SHA:

1. Egzon Azemi,
2. Qëndrim Sahiti.

3. Kompania rajonale e mbeturinave “Pastrimi”, SHA:

1. Sokol Berisha,
2. Vjosa Hamiti.

4. Ndërmarrja publike “Hortikultura”, SHA:

1. Valbona Ajeti,
2. Leonora Bajraktari.

5. Ndërmarrja publike “Trafiku Urban”, SHA:

1. Adrian Berisha,
2. Bukurije Canolli.

6. Ndërmarrja publike “Sport – Marketing”, SHA:

1. Adelina Fazliji,
2. Besnik Mujeci.

7. Stacioni i Autobusëve, SHA:

1. Mirsad Vitia,
2. Rifat Deri.

8. “Prishtina Parking”, SHA, në themelim:

1. Eman Rrahmani,
2. Drilon Pireva.

II.

Komisionet komunale të aksionarëve kanë të drejtë të veprojnë në emër të Komunës dhe duhet të veprojnë në përputhje me Ligjin e ndërmarrjeve publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare.

III.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlejë Vendimi 01. nr. 031 - 40374, dt. 18.02.2015, për caktimin e anëtarëve në komisionet komunale të aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-020/04-15223/18, më 18.01.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

